

D E K R E T
Nr.1030, datë 23.2.1995

PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË PRIVATIZIMI)

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushttuese”, për realizimin e privatizimit masiv të pronës shtetërore dhe ecurinë e mëtejshme të reformës ekonomike, me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Për privatizimin e pasurisë shtetërore nëpërmjet letrave me vlerë Këshilli i Ministrave emeton “Bono privatizimi (ose lekë privatizimi) të konvertueshme në aksione, në kapitale të pjesshme ose tërësore”.

Neni 2

Bono privatizimi (ose lekë privatizimi) të konvertueshme në aksione, në kapitale të pjesshme ose tërësore, të quajtura më poshtë “Bono privatizimi”, do të përfitojnë gjithë shtetasit, të cilët kanë vendbanim ligjor në qytet, që në datën 1.8.1991 janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile dhe që në datën e hyrjes në fuqi të këtij dekreti kanë mbushur moshën 18 vjeç, me përjashtim të kategorive të parashikuara në nenin 5 të këtij dekreti.

Neni 3

Bonot e privatizimit do të jenë të formës jo emërore, me vlerë nominale të shprehura në lekë privatizimi dhe lirisht të tregtueshme. Ato janë të vlefshme deri në datën 31.12.1998.

Neni 4

Bonot e privatizimit do të përdoren nga zotëruesi i tyre për të hyrë si aksionar, ortak ose pronar i plotë në shoqëritë tregtare, që do të krijohen nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore.

Hyrja në privatizimin e subjekteve, që zotërojnë bono privatizimi, është e lirë dhe pa asnjë lloj preference.

Neni 5

Nuk do të përfitojnë bono privatizimi kategoritë e shtetasve si më poshtë:

1. Personat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët kanë përfituar në natyrë ose në para nga procesi i privatizimit të pronës shtetërore sipas ligjit nr.7512, datë 18.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”.

2. Personat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët kanë përfituar në natyrë ose në para nga procesi i privatizimit të pronës shtetërore sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme”, dhe nr.234, datë 24.5.1994 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248, datë 27.5.1993 “Për disa masa për shpejtimin e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe

të mesme””. Përfashtohen rastet kur procesi i privatizimit është kryer nëpërmjet ankandit.

3. Personat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët kanë përfituar tokë sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, pavarësisht se ku e kanë vendbanimin.

4. Personat dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët kanë përfituar në natyrë ose në para nga aktet ligjore në fuqi për privatizimin e ndërmarrjeve bujqësore në bazë të vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.452, datë 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, nr.195, datë 16.4.1993 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.284, datë 25.5.1992”, nr.510, datë 26.10.1993 “Për privatizimin e mjeteve themelore, pasuri shtetërore e NB-ve”, si dhe nr.161, datë 8.4.1993.

Neni 6

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim shumat që do t’u jepen përfituesve sipas grup-moshave, vlerën nominale të bonove të privatizimit, procedurat e emetimit dhe të shpërndarjes së tyre, rregullat e përdorimit në procesin e privatizimit, rregullat e tregtimit, si dhe rregullat e tjera të nevojshme për zbatimin e këtij dekreti.

Neni 7

Personat që nëpërmjet falsifikimeve, mashtrimeve ose në çdo formë tjetër të paligjshme përfitojnë pa të drejtë bono privatizimi, dënohen me gjobë në masën 5 herë më shumë se vlera e përfituar.

Me vendosjen dhe arkëtimin e gjobave ngarkohen seksionet e financës në organet e pushtetit lokal.

Neni 8

Personat e ngarkuar për regjistrimin e qytetarëve që përfitojnë bono privatizimi ose që lëshojnë dokumente për këtë qëllim, kur me veprimet e tyre çojnë në përfitime të padrejta të bonove të privatizimit nga qytetarët, dënohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.

Neni 9

Ngarkohet Banka e Shqipërisë të shtypë bonot e privatizimit për llogari të Këshillit të Ministrave dhe sipas karakteristikave të përcaktuara nga Ministria e Financave.

Neni 10

Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, të përgatitë dispozitat ligjore për letrat me vlerë, si dhe dispozitat ligjore për organizimin dhe veprimtarinë e bursës (tregut të letrave me vlerë).

Ministria e Financave ngarkohet me përgatitjen e dispozitave ligjore për organizimin dhe veprimtarinë e fondeve investuese.

Neni 11

Ngarkohet Banka e Kursimeve për regjistrimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit.

Neni 12

Lekët e privatizimit të përfituara nga ish-të përndjekurit politikë, si dhe obligacionet që

do t'u shpërndahen ish-pronarëve për kompensimin e pasurisë së tyre, do të kenë të njëjtin trajtim si dhe bonot e privatizimit në procesin e privatizimit të pronës shtetërore.

Neni 13

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha